



M SH Rindërtimin

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 630, datë 29.7.2020

P Ë R

**MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE SHOQATËS BAMIRËSE “JETIMËT E BALLKANIT”
PËR BASHKËPUNIM NË FUSHËN E NDËRTIMIT TË BANESAVE
PAS FATKEQËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 20, të ligjit nr.97/2019, “Për miratimin e aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore””, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqatës bamirëse “Jetimët e Ballkanit”, për bashkëpunim në fushën e ndërtimit të banesave pas fatkeqësisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Autorizimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin për nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Bashkia Lezhë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA


Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ERION BRAÇE

**MINISTRI I SHETIT
PËR RINDËRTIMIN**

ARBEN AHMETAJ

A large, stylized handwritten signature in black ink, which appears to be 'Erion Braçe', is written over the printed name of the Deputy Prime Minister.